



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 124, datë 21.06.2019

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR DISA KËRKESA SHITESË PËR AKSIONARËT
THEMELUES, NDIKUES, SI DHE ANËTARIN EKZEKUTIV TË KËSHILLIT TË
ADMINISTRIMIT TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE TË SIPËRMARRJEVE TË
INVESTIMEVE KOLEKTIVE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe nenit 16, nenit 18 dhe nenit 23, të Ligjit nr. 10 198, datë 10.12.2009 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Rregullores “Për disa kërkesa shtesë për aksionarët themelues, ndikues, si dhe anëtarin ekzekutiv të Këshillit të Administrimit të shoqërisë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive”, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR
Deniz DERALLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI